



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org.Jedinica Org Unit	02
Nr.Prot. Prot.No	05-201
Nr.l faqeve Br.stranica No.pages	-4-
Data: Datum:	14, 01, 2025
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Ured Generalnog Sekretara / Office of the Secretary General

Prishtinë, 14.01.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7 / 01 Mars 2019), në zbatim të Shkresës nr. prot. 01/ 20 datë 13.01.2025 të Agjencisë për Informim dhe Privatësi, nxjerr këtë:

Qarkore Informative Nr. 01 /2025

Për: Të gjitha Institucionet shëndetësore

- Qëllimi:**
1. Informimi i të gjitha institucioneve shëndetësore për obligim të Ndryshimit të praktikës së Përpunimit të të Dhënave Personale në Sektorin e Shëndetësisë në zbatim të Shkresës nr. prot. 01/ 20 datë 13.01.2025 të Agjencisë për Informim dhe Privatësi
 2. Zbatimi i Ligjit Nr. 06/L-082 Për Mbrojtjen e të dhënave Personale

Obligimet e institucioneve shëndetësore :

1.Të gjitha Institucionet Shëndetësore, janë të obliguara për zbatimin e kësaj Qarkore informative : për ndryshimin e praktikës së përpunimit të dhënave personale në sektorin e shëndetësisë në zbatim të Ligjit Nr. 06/L-082 Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Shkresës nr. prot. 01/ 20 datë 13.01.2025 të Agjencisë për Informim dhe Privatësi.

2. Shtojcë e kësaj Qarkoreje është: Kërkesa nr. prot. 01/ 20 datë 13.01.2025 e Agjencisë për Informim dhe Privatësi për Ndryshimin e Praktikës së Përpunimit të të Dhënave Personale në Sektorin e Shëndetësisë

Dr. Naim Bardiqi

Sekretar i Përgjithshëm




Qarkorja i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Inspektoratit Shëndetësor/Farmaceutik;
- Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës
- Qendrat Rajonale të Shëndetit Publik
- Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale ;
- QKTGJK;
- Drejtorëve të DSHMS në Komuna;
- Drejtorit të SHSKUK dhe Drejtorëve të Spitaleve të Përgjithshme Regjionale;
- Drejtorëve /Udhëheqësve të Institucioneve Shëndetësore;
- Arkivit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI
AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST
INFORMATION AND PRIVACY AGENCY

IP



DATË:	13.01.2025
REFERENCË:	03/2025
PËR:	Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Shëndetësisë
CC:	Arben Vitia, Ministër, Ministria e Shëndetësisë
NGA:	Krenare Sogojeva Dërmaku, Komisionere, Agjencia për Informim dhe Privatësi
TEMA:	Kërkesë për Ndryshimin e Praktikës së Përpunimit të të Dhënave Personale në Sektorin e Shëndetësisë



I nderuari z. Bardiqi,

Në cilësinë e titullares së autoritetit mbikëqyrës (Agjencisë për Informim dhe Privatësi) në raport me institucionet publike, të cilat, sipas paragrafit 1 të nenit 2 të Ligji Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, kanë për obligim zbatimin e rregullave që burojnë nga ky ligj, përmes kësaj shkrese, po ju drejtohem për të adresuar çështjen e praktikës ekzistuese të tejkalimit të qëllimit të përpunimit të të dhënave personale, të identifikuar nëpër institucionet e mjekësisë primare, sekondare dhe terciare në Republikën e Kosovës.

Kompetencat ligjore të Agjencisë për Informim dhe Privatësi lidhen me mbikëqyrjen e zbatimit të LMDhP-së; ofrimin e këshillave organeve publike dhe private për çështjet e lidhura me mbrojtjen e të dhënave personale; promovimin dhe përkrahjen e të drejtave themelore për mbrojtjen e të dhënave personale; vendosjen lidhur me ankesat e qytetarëve (pacientëve), në cilësinë e subjekteve të të dhënave personale; ofrimin e opinionëve dhe këshillimit të institucioneve të shtetit dhe organeve të tjera të brendshme mbi masat legjislative dhe administrative në lidhje me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të personave fizikë, për sa i takon përpunimit të të dhënave personale.

Para se të shpalos thelbin e kësaj kërkesë, e cila paraqitet si rrjedhojë e njoftimeve të pacientëve (qytetarëve) që autoriteti ynë ka pranuar, më lejoni që me mirësjellje t'ua nënvizoj se 'përpunim' i të dhënave personale konsiderohet çdo veprim ose seri veprimesh që kryhet nga kontrolluesi i të dhënave (apo edhe përpunuesi, në emër të kontrolluesit), siç është cilido institucion i shëndetësisë në vendin tonë, ndaj të dhënave personale të individëve, me mjete automatike ose jo, si: mbledhje, regjistrim, organizim, strukturim, ruajtje, përshtatje, ndryshim, tërheqje, konsultim, përdorim, publikim nëpërmjet transmetimit, shpërndarje ose ofrim, njësim apo kombinim, kufizim, fshirje, verifikim dhe jo vetëm.

Bazuar në njoftimet e pranuar nga qytetarët vetëm gjatë vitit të kaluar, mes tjerash, është identifikuar tejkalim i qëllimit të përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, respektivisht pacientëve, me rastin e pranimit apo regjistrimit të tyre në zyrat pritëse të institucioneve shëndetësore të tri niveleve të mjekësisë.

Kategoria e ankuesve, e cila ka ngritur shqetësimet e tyre për praktikën e përpunimit të të dhënave personale, të ndjekura nga këto institucione shëndetësore, të cilat, për AIP-në konsiderohet si

tejkalim i qëllimit të përpunimit të të dhënave, janë veteranë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kjo kategori, sipas ligjit përkatës, cilësohet si kategori qytetarësh, e cila lirohet nga obligimi i pagesës me rastin e pranimit të shërbimeve shëndetësore.

Sipas njoftimeve të pranuar, në rastet e qytetarëve/pacientëve (dhe familjarëve të ngushtë), të cilët janë bartës të kartelës së veteranit të UÇK-së, të cilët, sipas paragrafit 1 të nenit 23 të Ligjit Nr.04/261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, gëzojnë të drejtën për shërbime shëndetësore falas, në shumë raste u është mohuar kjo e drejtë, me arsyetimin se kartela e cila dëshmon statusin e veteranit është e skaduar. Kartelat e lëshuara nga Organizata e Veteranëve të Luftës kanë afat njëvjeçar. Lëshimi i kartelës së skaduar i nënshtrohet një pagese prej €15, në emër të anëtarësisë dhe shpenzimeve të prodhimit të të njëjtës.

Një veteran luftëtar e fiton statusin përkatës përmes procesit të verifikimit nga komisionet përkatëse të ngritura nga shteti dhe, si i tillë, është i përhershëm, nëse ndërkohë, sipas një procesi riverifikimi, nuk është shfuqizuar. Të drejtën për lirim nga pagesa për marrjen e shërbimeve shëndetësore e garanton statusi i veteranit, jo pagesa vjetore e anëtarësisë. Mbi këtë bazë, në rastet kur punonjësit e sektorit shëndetësor kanë dyshime lidhur me statusin e një pacienti të caktuar, për të qenë në përputhje me parimet e përpunimit të të dhënave personale, do të duhej që të dhënat e kartelës së paraqitur t'i dërgonin tek Organizata e Veteranëve të Luftës për verifikim dhe pa marrë informatë kthyesë nga kjo organizatë, të mos i mohohet e drejta për të marrë shërbime shëndetësore pacientit, i cili ka prezentuar një kartelë të tillë. Afati i skaduar i një karteje të këtillë nuk paragjykon humbjen e statusit të veteranit luftëtar.

Tejkalimi i qëllimit të përpunimit të të dhënave personale, sipas paragrafit 3 të nenit 4 të LMDhP-së, sipas praktikës aktuale, të dëshmuar nga ankuesit pranë AIP-së, është duke ndodhur me rastin e mospërfilljes së parimit të lartpërmendur [parimi i minimizimit të të dhënave personale], sepse punonjësit shëndetësorë, duke u thirrur në akte të brendshme të ministrisë, komunës përkatëse apo ShSKUK-së, kërkojnë të dhëna shtesë e rrjedhimisht mosofrim të shërbimit shëndetësor, që në thelb përbën edhe shkelje të të drejtave të njeriut.

Për t'a arritur qëllimin e keqpërdorimit eventual të këtij statusi, AIP ju këshillon përpilimin e një baze të dhënash (nëse nuk ekziston tashmë) të qytetarëve/pacientëve, të cilët gëzojnë të drejtën e marrjes së shërbimeve shëndetësore falas. Me rastin e paraqitjes së një dëshmie nga pacienti, e cila e liron nga pagesa, e njëjta do të autentifikohet me sistemin informativ ekzistues dhe do të shmangeshin përplasjet e panevojshme, të deklaruara nga ankuesit para recepsioneve të institucioneve shëndetësore.

Agjencia për Informim dhe Privatësi, duke pasur para sysh raportet shumë të mira ndërinstitutionale, si me MSh-në ashtu edhe me ShSKUK-në e komunat (në kuadër të të cilave, si përpunues të të dhënave është mjekësia primare, nën mbikëqyrjen e drejtorive përkatëse për shëndetësi), deri tash nuk ka zhvilluar inspektive, sipas këtyre njoftimeve, të gjeturat e të cilave do të mund të derivonin në ndëshkime eventuale, sipas Kreut XXI (Dispozitat Ndëshkuese) të Ligjit Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Duke besuar që ministria juaj do të shfrytëzojë rrugët zyrtare të komunikimit me të gjitha institucionet shëndetësore për t'a përmirësuar këtë praktikë, unë, në cilësinë e titullares së organit mbikëqyrës, ju falenderoj paraprakisht për bashkëpunimin!

Gjithsesi, me qëllim të rregullimit të kësaj çështjeje, ne jemi të gatshëm të organizojmë një takim të përbashkët me ju.

Me respekt,